



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS, AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH
NË VEPRIMTARINË E AVOKATIT TË POPULLIT DHE SHOQËRISË CIVILE**

3 prill 2012

I nderuar z. Totozani,
Përfaqësues të shoqërisë civile,
Zonja dhe zotërinj!

Së pari, dëshiroj t'ju falënderoj për ftesën në këtë veprimtari të rëndësishme. Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit do të përbëjë bazën dhe kuadrin për një bashkëpunim të mëtejshëm të përforcuar midis Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues i pavarur, dhe organizatave të shoqërisë civile që janë aktive në Shqipëri.

Shumë OJF kanë treguar përgjatë viteve përkushtimin e tyre në trajtimin e çështjes së të drejtave të njeriut dhe shkeljeve të mundshme. Ato kanë kontribuar në mënyrë efikase në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, veçanërisht të grupeve më të cënueshme. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka bashkëpunuar ngushtë me shumë prej këtyre organizatave dhe i ka mbështetur në përpjekjet e tyre të lavdërueshme.

Ne të gjithë mund të kontribuojmë në përforcimin e gëzimit të plotë të të drejtave të njeriut në Shqipëri. Ndikimi më i madh vjen kur të gjithë aktorët bashkojnë forcat, si institucionet, ashtu edhe shoqëria civile.

Kam kënaqësinë të jem i të njëjtit mendim me shumë të tjerë që Avokati i Popullit ka treguar se është një nga institucionet më të rëndësishme në vend në lidhje me këtë temë, gjë që pasqyrohet edhe në Kushtetutën e Shqipërisë: ky institucion mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka mbështetur veprimtarinë e Avokatit të Popullit që nga krijimi i kësaj zyre dhe, sipas mendimit tonë, ky institucion është shndërruar në një aktor kyç në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Në të

shkuarën, Avokati i Popullit ka dhënë shembullin e të qenit i drejtë dhe i paanshëm politikisht në hetimin profesional të rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Ne kemi besimin se, edhe nën drejtimin e z. Totozani si Avokat i Popullit, i zgjedhur me konsensus, ky institucion do të vazhdojë të mbajë këtë pozicion kushtetues të paanshëm.

Edhe pse disa mund të pretendojnë se rekomandimet e Avokatit të Popullit nuk janë detyruese, përmbushja dhe zbatimi i tyre nga administrata publike tregon qartë përkushtimin e saj ndaj parimeve demokratike. Do të doja të përgëzoja në mënyrë të veçantë punën e Zyrës së Avokatit të Popullit si Mekanizmi Vendas i Parandalimit të Torturës. Edhe pse ky mekanizëm është krijuar vetëm kohët e fundit, ka treguar përkushtim dhe ka punuar shumë. Të punuarit ngushtë me shoqërinë civile, në vazhden e punës që Avokati i Popullit ka bërë në të kaluarën, do të përforcojë më tej efikasitetin e këtij mekanizmi, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe ekspertizës.

Prezenca e OSBE-së ka mbështetur punën e Avokatit të Popullit në shumë mënyra, edhe duke ndihmuar me trajnim të specializuar të stafit të Avokatit të Popullit për të kryer funksionet e tyre në mënyrë efikase. Prezenca e OSBE-së ka dhënë mbështetjen edhe në projekte të ndryshme të Avokatit të Popullit duke kryer së bashku një sërë aktiviteteve të suksesshme. Vlen për t'u veçuar si një aktivitet i frytshëm, bashkëpunimi në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut për personat të cilëve iu është privuar liria, si dhe veprimtari ndërgjegjësimit e në lidhje me të drejtat e personave të mbajtur në komisariatet e policisë.

Z. Totozani,

Zonja dhe zotërinj,

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri kërkon të vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë dhe të frytshëm me Zyrën e Avokatit të Popullit. Së bashku, ne po eksplorojmë ide të reja si mund të trajtojmë çështjet në lidhje me diversitetin kulturor në vend, duke i dhënë vëmendje të veçantë ndërgjegjësimit të administratës publike dhe organeve shtetërore për të qenë më të ndjeshëm ndaj të drejtave të të gjithë njerëzve, pavarësisht racës, gjinisë apo orientimit seksual. Shoqëria civile duhet dhe mund të jetë një shtysë në këto fusha. Ne i ftojme të kontribuojnë në mënyrë konstruktive në këto përpjekje.

Faleminderit!